



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 859/3 Prot

Tiranë, më 21/06 2019

VENDIM

Nr. 18, datë 21.06 2019

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 859 Prot., datë 31.05.2019, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Avokaturës së Shtetit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Me kërkesën e datës 21.05.2019, ankuesi ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion:

- *Kopje e vendimit të arbitrazhit të dhënë nga Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në Investime, datë 29.04.2019 me palë Hydro S.r.l etj., kundër Shqipërisë.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me Urdhrin nr. 183, datë 11.06.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u kontaktua me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit i cili sqaroi sa më poshtë:

“Në përgjigje të kërkesës së z. _____, kemi vënë në dispozicion, komunikimin e datës 25.03.2019, të sekretariatit të ICSID, ku sqarohet se procesi në lidhje me çështjen nr. ARB 15/28, datë 29.04.2019 “Hydro srl k. Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet konfidencial dhe nuk do të bëhet publik. Ky komunikim mes palëve, ka dalë në përputhje me parashikimet e Konventës së ICSID. Kërkesit i është sqaruar gjithashtu se, Sekretariati i Tribunalit ka bërë me dije Avokaturën e Shtetit, se me kërkesë të palës paditëse, ky vendim do të nënshtrohet rregullave të konfidencialitetit dhe gjykata dhe palët nuk duhet ta bëjnë publik atë. Këto rregulla burojnë nga detyrimet e marra përsipër nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7515, datë 01.10.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikeve të Investimeve”.

Për këtë arsye, vendimi dhe dokumentet e procesit nuk janë bërë publike në faqen zyrtare të Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikeve të Investimeve (ICSID).

Publikimi i vendimit apo i të dhënave të tjera, do të përbënte shkelje të detyrimeve të marra përsipër para tribunalit të ICSID dhe mosrespektim të së drejtës ndërkombëtare.

Në këto kushte, vendimi i nënshtrohet rregullave të konfidencialitetit të mbrojtura nga akte ndërkombëtare që kanë epërsi sipas nenit 116, pika 1 b) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe si i tillë nuk mund të bëhet publik.

Ndërkohë referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 17, pika 2, gërma “dh”, parashikohet se: “e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse do të shkaktonte një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të shtetit në barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor”, informacioni i kërkuar nuk mund të bëhet publik. Duke qenë se jemi në një proces të hapur me paditësin dhe vendimi nuk ka marrë ende formë të prerë, publikimi i vendimit, do të përdorej si shkelje nga paditësi në shkallët e tjera të gjykimin dhe kjo do të ndikonte tek trupa gjyqësore në lidhje me imazhin e Shqipërisë për respektimin e detyrimeve ndërkombëtare.

Për të gjitha më sipër, vlerësojmë se informacioni i kërkuar nuk mund të bëhet publik”.

Pas parashtrimit të fakteve u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e përfaqësuesit të Autoritetit Publik.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me informacion i cili i nënshtrohet dhe rregullohet me dispozitat e ligjit nr. 7515, datë 01.10.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikeve të Investimeve”, dispozitat e Konventës “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”, New York, datë 10.06.1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 8688, datë 09.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”, së

bashku me kufizimet që këto ligje mund të përmbajnë lidhur me publikimin e informacionit.

Neni 48 i Konventës së ICSID, parashikon se ICSID nuk do të bëjë publikimin e vendimit nëse nuk ka miratimin e palëve. Sipas deklaramit të Koordinatorit për të Drejtën e Infomimit gjatë hetimit administrativ, palët kanë dakordësuar mbi detyrimin për të mos publikuar vendimin nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar midis shtetit Shqiptar dhe ICSID.

Nga ana e tij, ankuesi pretendon se ky detyrim qëndron vetëm për ICSID dhe Avokatura e Shtetit duhet ta publikojë vendimin në kuadër të veprimtarisë së ushtrimit të detyrës së saj.

Lidhur me këtë argument vlerësohet se, objekt i kërkesës së ankuesit është një vendim i cili nuk ka marrë ende formë të prerë duke qenë se palët janë në proces arbitrazhi dhe nuk kanë kërkuar njohjen e tij pranë gjykatave të Republikës së Shqipërisë. Bazuar në nenin 3 të Konventës së New York, datë 10.06.1958 “Për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”, secili shtet kontraktues do të njohë vendimet e arbitrazhit si vendime të detyrueshme dhe do t’i zbatojë ato në përputhje me rregullat e procedurës së vendit ku vendimi do të zbatohet. Në kushtet kur vendimi nuk i është nënshtruar procedurës së njohjes dhe nuk ka marrë formë të prerë, ai është i ankimueshëm. Për rrjedhojë publikimi i tij do të paragjykonte procesin.

Në ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, ankuesi pretendon se bazuar në nenin 146 pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “*Vendimet publikohen në çdo rast*”.

Komisioneri vlerëson se kjo dispozitë është e zbatueshme në momentin e njohjes së vendimit të arbitrazhit në Republikën e Shqipërisë, pas marrjes formë të prerë të tij.

Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh interesin që paraqesin publikimet e vendimeve që janë objekt i veprimtarisë së institucionit, Zyra e Komisionerit rekomandon bërjen publike nga ana e Autoritetit Publik të vendimit në fjalë, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe marrjes formë të prerë të tij, moment i cili pasohet me njohjen e vendimit në Republikën e Shqipërisë. Kjo do t’i shërbente transparencës së veprimtarisë së Autoritetit Publik.

Theksojmë se ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ndër kufizimet e tij, në nenin 17, parashikon, se: “{...} 1. *E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor; {...}*”.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën Qendrës “Res Publica” ndaj Avokaturës së Shtetit, Komisioneri vlerëson se ankesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 859 Prot., datë 31.05.2019 të Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Avokaturës së Shtetit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 21.06.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

